

## SËMUNDJET KËRPUDHORE

Fletëpërdredhësja e gjetheve  
(*Taphrina deformans*)



**RREZIK!**

**RREZIK!**



### MBROJTJA KUNDËR FLETËPËRDREDHËSES

Trajtime në qetësi dimërore		Trajtime në vegjetacion	
Fazat kur bëhen trajtimet me fungicide			
			
Rrëzimi i gjetheve	Krasitja dimërore	Zgjimi vegetativ	Fillim vegjetacioni

## MENDIM BAÇAJ ATHINA LLAMBRO

### SËMUNDJET TEK KULTURAT BËRTHAMORE

#### 1. Sëmundjet bakteriale

##### 1.1. Kanceri bakterial i pjeshkës, vyshkja bakteriale dhe kroma bakteriale e frutave

##### Mënyra e përhapjes

Bakteri mbijeton në indet përçuese të degëve të infektuara, në sythat dhe në kanseret e degëve.

##### Masat e luftimit

Përdorimi i materialit të pastër, evitimi i tokave shumë ranore. Eliminimi i degëve të infektuara, të bëhen krasitje të vona, dezinfektimi i veglave të krasitjes.

##### Momentet kritike

Për fermerët: blloqet e reja të mbillen me material të pastër.

#### 2. Sëmundjet kërpudhore

##### 2.1. Kalbëzimi i frutave (Monilia)

##### Mënyra e përhapjes

Infeksioni përhapet nëpërmjet konideve.

##### Bimët strehuese:

Kajsia, qershia, bajamja, pjeshka, kumbulla.

### **Shenjat e sëmundjes**

Në lule: nxihen dhe thahen duke mbetur të varura në degë.

Në degë: formohen njolla të shtypura, që gradualisht kthehen në plagë kanceroze të hapura

Në fruta: frutat e rinj kalben dhe mbulohen me një masë që është frutifikimi konidial.

### **Masat e luftimit**

Kajsia: është mirë të bëhet trajtimi para lulëzimit. Kryhen deri në tre trajtime në vit.

**Qershia:** kryhet vetëm një trajtim kimik, në rast se kushtet klimatike janë të favorshme (shira dhe lagështi e lartë ajrore) dhe shfaqen shenjat e jashtme të sëmundjes.

**Bajamja:** këshillohet të trajtohet para lulëzimit.

**Pjeshka:** trajtimet kimike kryhen vetëm para lulëzimit, në rastet kur sëmundja arrin nivelin e dëmit ekonomik.

**Kumbulla:** këshillohen të kryhen trajtime kimike para lulëzimit.

### **Këshilla praktike**

Për fermerët: të bëhen plehrime azotike të balancuara.

Për shërbimin fitosanitar: të bëhen vrojtme në fushë dhe të analizohen degët e bimëve të dyshuara për praninë e sëmundjes.

### **Kalbëzimi i frutave**

(*Monilinia laxa*, *Monilinia fructigena*)



## **2.2. FLETËPËRDREDHËSJA E GJETHEVE**

Shkaktari : *Taphrina deformans* (Berk) Tul

### **Mënyra e përhapjes**

Paraziti kalon dimrin me organe të shumëzimit të lokalizuara në të çarat e degëve ose në luspat e sythave.

Bimët strehuese: pjeshka dhe bajamja

### **Shenjat e sëmundjes**

Në gjethe: shenjat e para duken në gjethet e reja të porsaçelura në formë të fryrjeve të shoqëruara me antocianinë (ngjyrë e kuqe).

Gjethet e infektuara bien para kohe.

Në fruta: infeksioni në fruta është më i rrallë.

Në lule: vërehet deformim dhe dështim i tyre.

Lastarët: marrin pamje mishtore me forma të çrregullta.

### **Masat e luftimit**

Bëhet një trajtim kimik me rënien e gjetheve. Trajtimi tjetër parashikohet pas krasitjes dimërore, trajtimi i tretë bëhet në fazën e porsafryrjes së sythave. Në rastet e infeksioneve të përvitshme dhe kur kushtet klimatike janë të favorshme për sëmundjen, bëhet dhe trajtimi kimik në fazën e fillimit të vegetacionit.

Lënda aktive: bazë bakri, ziram, dobinë.

### **Këshilla praktike**

Për fermerët: të përdoren plehra të ekuilibruara azotike dhe të bëhen ujitje me kriter. Në infeksione të rënda të bëhet

grumbullimi i degëve dhe largimi i tyre duke i djegur  
përfundimisht.

Për shërbimet fitosanitare: të bëhen vrojtme në fushë dhe analiza  
mikrobiologjike të materialit bimor të dyshimtë.